



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.01.2022, ora 15:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministria e Financave dhe Ekonomisë, (Huamarrësi) dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri”.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Blerina Gjylameti, Shpresa Marnoj, Enslemvera Zake, Arbi Agalliu, Dashamir Shehi, Emilja Koliqi, Edmond Spaho, Benet Beci, Anila Denaj, Bujar Leskaj, Ilir Topi

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Alfred Rushaj, Agron Shehaj, Erion Braçe, Vullnet Sinaj, Sorina Koti, Antoneta Dhima, Pranvera Resulaj, Alban Xhelili,

Të ftuar:

Delina Ibrahimaj – Ministre e Financave dhe Ekonomisë.

Kesjana Halili - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Teuta Turani - Këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Ilir Bejtja - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Enea Karakaçi - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ilda Malile - Drejtor (OSHEE)

Adea Pirdeni - Zëvendësministre e Drejtësisë.

Besmir Beja - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Nikolla Lera - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale.

Zarina Taja - Drejtor i Drejtorisë së Harmonizimit Fiskal.

Ilda Koja - Drejtor i Drejtorisë Ligjore dhe Teknike.

Saimir Mucmataj - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator.

Idlir Gjata - Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Vasilika Vjero - Zëvendësministër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Zarina Taja - Drejtor i Drejtorisë së Harmonizimit Fiskal.

Nikolla Lera- Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale.

Idlir Gjata - Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Fillojmë me mbledhjen komisionit për seancën e pasdites. Verifikojmë kuorumin, i cili është. Mund të thirret media. Mbledhjen e deklaroj të hapur.

Sot në rendin e ditës kemi dy çështje, projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministria e Financave dhe Ekonomisë, (Huamarrësi) dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri”. Relatore kemi zonjën Shpresa Marnoj.

Çështje të dytë kemi projektligjin “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”.

Për pikën e parë kemi të ftuar ministren zonjën Delina Ibrahimaj, zonjën Kesjana Halili, drejtoreshë të Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik, si dhe zonjën Teuta Turani, këshilltare.

Ndërkohë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kemi zotin Ilir Bejtja, zotin Enea Karakaçi dhe zonjën Ilda Malile.

Pa humbur kohë, dua t'u jap fjalën përfaqësuesve të ministrive, pastaj relatores për të vijuara më tej me pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet.

Fjala për zonjën Ibrahimaj.

Delina Ibrahimaj – Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar i komisionit,

Rritja e ndjeshme e çmimeve të energjisë në tregun ndërkombëtar vuri edhe vendin tonë në një situatë të vështirë nga pikëpamja energjetike. Pavarësisht këtyre vështirësive qeveria i ofroi OSHE-së mbështetje maksimale me financime për të siguruar energji pa ndërprerje për qytetarët. Sektori energjetik ka qenë në vëmendjen e qeverisë edhe përpara kësaj situatë të vështirë në masa të marra për ristrukturimin e sistemit, për rritjen e kapaciteteve prodhuese, si edhe për diversifikimin e burimeve prodhuese të energjisë. Në funksion të përmirësimit të këtij sektori vjen edhe marrëveshja e huas që diskutojmë sot ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim. Kjo hua në shumën 50 milionë euro, shërben për një mbështetje buxhetore të lidhur me reformat e ndërmarra në sektorin energjetik në Shqipëri.

Rikujtoj se në vitin 2018 Ministria së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, nënshkruan memorandumit e mirëkuptimit me KfW-në dhe AFD-së, me vlerë totale prej 250 milionë eurosh, për reformimin e sektorit të energjetik. Si pjesë e memorandumit u diskutua dhe u dakordësuar që kjo mbështetje do të alokohej nga kreditorët në bazë të zbatimit të masave të reformës. Zbatimi me sukses i deritanishëm i reformës ka mundësuar disbursimin gjatë vitit 2021 të mbështetjes buxhetore nga KfW-ja në shumën 100 milionë euro.

Gjithashtu, bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit, është planifikuar edhe mbështetje buxhetore 100 milionë euro, 50 milionë nga KfW-ja dhe 50 nga AFD-ja, për të vazhduar zbatimin e pjesës tjetër të elementëve të reformës. Që prej nënshkrimit të memorandumit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka zbatuar një plan strategjik me një sërë masash reformuese, me qëllim krijimin e një tregu të organizuar sipas modelit të Bashkimit Europian, i cili bazohet në çmime konkurruese dhe udhëhiqet nga parimet e të qenit transparent, jodiskriminues dhe i qëndrueshëm.

Disa arritje të reformës gjatë vitit 2021 përfshijnë nënshkrimin e marrëveshjes për detyrimet e prapambetura ndërmjet KESH-it dhe OST-ës, rishikimin e metodologjive ekzistuese,

analizën e kostos së shërbimit dhe rishikimin e aplikimeve të mëparshme tarifore, finalizimin e studimit mbi skemat e mbështetjes sociale. Dëshiroj të theksoj se mbulimi i nevojave për financimin nëpërmjet mbështetjeve buxhetore është një ndër instrumentet më të favorshëm të financimit, duke qenë se kemi të bëjmë me kredi në trema të buta dhe të alokuara nga institucione ndërkombëtare zhvillimi. Financimi i akorduar nga partnerët tanë ndërkombëtarë jo vetëm që jepet në terma më të favorshëm se kushtet e tregut, por mundëson suport për realizimin e reformave të ndryshme dhe të rëndësishme për zhvillimin e vendit, sikundër është reforma e energjisë. Ndër mbështetjet buxhetore të akorduara gjatë vitit 2021, të cilat vlejné të përmenden janë mbështetja e Bankës Botërore në vlerë 80 milionë dollarë, për mbështetjen e qëndrueshmërisë dhe rritjes fiskale, mbështetja buxhetore e Bashkimit Europian me vlerë 180 milion euro për asistencën makro-fiskale dhe mbështetja buxhetore e KfW-së në kuadër të reformës së energjisë 100 milionë euro.

Duke ritheksuar angazhimin tonë për të mbështetur sektorin e energjetik me financimet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës, ju ftoj ta miratoni këtë projektligj.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Brahimja.

Relatorja, zonja Marnoj.

Shpresa Marnoj – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit zonja Ministre!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri, është propozuara nga Këshilli i Ministrave dhe është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit përgjegjës bazuar në nenet 32 dhe 38 të Rregullore së Kuvendit. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1, 83, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës të Republikën së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83, pika 1 dhe 121 pika 1, germa “ç” Kushtetutës nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja kuadër e huas është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 518, datë 18.9.2021 dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për financimin e

projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri”, nëpërmjet së cilës qeveria e Republikës së Francës i jep mundësi Republikës së Shqipërisë të marrë një kredi të butë, për të përmirësuar proceset e reformës sektoriale në sektorin energjetik në Shqipëri në shumën maksimale totale, në vlerën 50 milionë euro.

Përmes VKM-së nr.742/2018 “Për miratimin e planit strategjik për reformimin e sektorit të energjisë në Shqipëri”, e miratuar bazuar mbi memorandumun e mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, KfW-së dhe AFD-së 2018, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë aktualisht po implementon planin strategjik për reformimin e sektorit të energjisë, plan ky që parashikon një sërë masash reformuese, me qëllim krijimin e një tregu të organizuar, sipas modelit të Bashkimit Europian, i cili bazohet në çmime konkurruese dhe udhëhiqet nga parimet e të qenit transparent, jodiskriminues dhe i qëndrueshëm, duke drejtuar reformën e sektorit të energjisë në përputhje me udhërrëfyesin që parashikon plotësimin me sukses të 11 elementeve të reformës në fundvitin 2020 dhe vazhdimin e 7 elementeve të tjera.

Nëpërmjet këtij programi synohet konsolidimi i ndarjes së OSHEE-së Furnizuesit Universal dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, funksionimin e Bursës të Energjisë (APEX) dhe hapjen graduale të tregut të shitjes me pakicë, së bashku me krijimin e një tregu konkurrues të energjisë.

Përshkrimi i programit.

Me qëllim mbështetjen e Shqipërisë në zbatimin e një reforme të plotë në sektorin e energjisë KfW dhe AFD japin një hua bazuar mbi politika të tilla, që disbursimi i saj do të bazohet në monitorimin e zbatimit të elementëve të reformës së politikave.

Objektivat e huas së bazuar në politika sipas marrëveshjes synojnë t’i krijojnë mundësi qeverisë së Shqipërisë për të arritur dhe realizuar angazhimin e saj ndërkombëtar në lidhje me reformën në sektorin e energjisë; të mbështesë qeverinë shqiptare në krijimin e një mjedisi tregu në kuadër të sektorit shqiptar të energjisë, që bazohet në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Huaja e bazuar në politika strukturohet në dy faza.

Faza e parë, konsiston në dhënien e transhit të parë në kohën e duhur, që të mund të shqyrtohet më pas në buxhet me parakushtin për plotësimin në nivel të përshtatshëm të detyrimeve të miratuara.

Faza e dytë, do të pasojë menjëherë fazën e parë me disbursimin e trashit të dytë.

Marrëveshja ka parashikuar, gjithashtu, ndër të tjera edhe një skemë monitorimi. Për këtë qëllim KfW-ja, në emër të qeverisë gjermane, dhe AFD-ja, në emër të qeverisë franceze, po

krijonjë një instrument huadhënës, disbursimi i të cilit do të bazohet në monitorimin e zbatimit të elementeve të reformës së politikave të përcaktuara në udhërrëfyesin për këtë qëllim.

Ky projektligj përmban dy nene.

Në nenin 1 parashikohet ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për financimin e projektit dhe në nenin 2 parashikohet hyrja në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrëveshja në vetvete përbëhet nga 18 pika gjithsej, ku secila pikë ndahet në disa nënpika me nga 12 skedule, të cilat konkretisht janë: përkufizimet; interpretimi; përshkrimi i programit; plani i financimit; skema e monitorimit; kushtet pararendëse; formulari i kërkesës për disbursim; formulari i konfirmimit të disbursimit dhe normës; formular i kërkesës së konvertimit të normës; formulari i konfirmimit të konvertimit të normës; informacione që mund të publikohen në faqen e internetit të qeverisë franceze dhe faqen e internetit të huadhënësit, si dhe plani i angazhimit mjedisor dhe social.

Për zbatimin e aktit ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Termet financiarë të marrëveshjes së huas paraqiten si më poshtë: shuma është 50 milionë euro; interesi euribor 6-mujor + 1.35%; komision angazhimi 0,25 % në vit; afati i ripagimit 12 vjet; periudhë pa pagesë principali 3 vjet; tarifë menaxhimi 0.75%. Zbatimi i këtij projekti në këtë fazë nuk do të ketë efekt financiar shtesë në buxhetin e shtetit.

Për gjithë sa më sipër evidentova, duke vlerësuar se ratifikimi i marrëveshjes së huas për financimin e projektit do të mundësojë përmirësimin e proceseve të reformës sektoriale në sektorin energjetik në Shqipërisë si një ndër sektorët më jetikë, ku në ditët e sotme vendi ynë po përballet me temperatura jonormale dhe me një mot tepër të ftohtë, ku pa dyshim ata që i vuajnë më shumë pasojat janë qytetarët në zonat malore apo rurale, biznesi i vogël, fermerët e të tjetër, dhe nevoja për të pasur një mbështetje të vazhdueshme të këtij sektori është e domosdoshëm, ndaj i ftoj të gjithë anëtarët e komisionit ta miratojmë.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Marnoj!

Përfaqësuesit e Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës duan të shtojnë diçka? Jo.

Atëherë, Zoti Agalliu.

Arbër Agalliu – Unë kam disa pyetje, në fakt, se u bënë disa herë që mblidhemi dhe diskutojmë pjesën e borxhit. Prej formimit tim profesional nuk e shoh me skepticizëm marrjen e borxhit, pasi është instrument zhvillimi patjetër, por ajo që shikoj me skepticizëm dhe me shumë

pikëpyetje është mënyra e menaxhimit të borxhit. Pra, a ka mundësi institucioni përkatës të gjenerojë fonde nga çka mbulon dhe jo të shkojmë te borxh? E para.

E dyta, a kemi ne ndonjë studim rentabiliteti? Sepse po të vëmë re, afatet e borxheve janë 10-vjeçare, 7-vjeçare, 10-vjeçare, ky i sotmi është 12 vjet, pasi kjo gjë nuk impakton vetëm periudhën aktuale, por patjetër që impakton edhe brezat në vijim. Si ndikon kjo në ekonomi? Çfarë përfitimesh ka? Këtu thuhet që ka të bëjë me mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri. Ndërkohë do të ishte mirë të kishim një përmbledhje të saktë për të ditur se ku konkretisht do të jetë investimi. Çfarë do të bëhet me këtë borxh? Ku do të shkojë ai? Cili është impakti që ka në ekonomi? A mundet ose jo të zhvillohej ndryshe ky investim? Sepse unë nuk di, por të paktën në zonën që mbuloj mund të ketë më shumë se 35 vjet dhe këtë e them me përgjegjësi që nuk ka investime në sektorin e energjisë, për ish-bashkinë Orikum.

Zonja ministre e Energjetikës e di këtë çështje. Nga komunikimet që kemi pasur në komision, ka thënë se ka informacion edhe kompania që është duke punuar për tunelin e Llogorasë dhe për bajpasin, pasi në atë zonë ka dëmtime të pajisjeve të tyre, por kjo është çështje tjetër. Çështje është se banorët e asaj zone prej vitesh e vuajnë mungesën e energjisë. Për ta përmbledhur, a ka një studim që tregon se marrja e këtij borxhi do të na kthehet në ekonomi dhe cili është impakti i tij? A do të ishte e mundur që investimi të zhvillohej jo me borxh, por duke qenë më eficient në sektorin përkatës, si dhe në elemente të tjerë të buxhetit të shtetit?

Faleminderit?

Eduard Shalsi – Ka ndonjë koleg tjetër pyetje?

Po, zoti Leskaj.

Bujar Leskaj – Unë kam një pyetje edhe për të ftuarit, edhe për ju, kryetar, si përfaqësues me zë i maxhorancës. A mundet, të paktën, t'i kurseni këtij populli lodhjen dhe të mos përdorni fjalët “reforma”, “reforma”, “qeveri e reformave”? Përse nuk e quani veten ajo çka jeni me të vërtetë, “qeveria e borxhit”, “moxhoranca e borxhit”? Do të jeni më të nderuar te shqiptarët.

Eduard Shalsi – Përgjigjuni ju, se po të flas unë për reformat, pastaj do të duhet ta gdhijmë këtu bashkë me zotin Leskaj.

Delina Ibrahimaj – Atëherë, për të gjitha pyetjet dhe komentet lidhur me borxhin dhe jo me marrëveshjen aktuale që kërkohet të miratohet, unë dua të ritheksoj që në fakt kjo qeveri ka një strategji afatmesme për menaxhimin e borxhit, e cila rishikohet herë pas here dhe gjatë vitit 2022 do të vijojë të rishikohet. Synimet e strategjisë afatmesme për menaxhimin e borxhit, ndër më kryesore janë: ulja e kostos së borxhit dhe rritja e maturitetit të borxhit. Të dyja këto qëllime

janë arritur nga kjo qeveri. Në vitin 2013 kostoja mesatare e borxhit shqiptar shtetëror ka qenë 4, 9%, ndërkohë që në vitin 2021, nga të dhënat paraprake që ne kemi, është 2,9%, pra ka pasur një reduktim të kostos. Ndikim në reduktim të kostos kanë pasur pikërisht marrëveshjet e huamarrjes si kjo që vjen sot në këtë komision për miratim, pasi janë marrëveshje që kanë një kosto më të ulët sesa huamarrja tradicionale nëpërmjet tregut të brendshëm apo të emetimit të eurobondeve.

Nga ana tjetër, dua të ritheksoj, siç thatë edhe ju, se borxhi nuk është gjë e keqe dhe borxhi duhet të përkthehet në rritje ekonomike. Kjo ka ndodhur. Borxhi i marrë në të gjitha rastet nga kjo qeveri, që në vitin 2013, është përkthyer në norma më të larta të rritjes ekonomike. Mesatarisht rritja reale e PPB-së ndaj rritjes së stokut të borxhit në periudhën 2005-2013 ka qenë 0,55, ndërkohë në periudhën 2014 - 2019, (pra po marr një periudhë kur ekonomia ka qenë në një rritëm normal dhe nuk ka pasur goditje) ka qenë 1,83. Ndërkohë, po të marrim të gjithë periudhën e qeverisjes, 2014-2021 bashkë me goditje dhe bashkë me rritjen e stokut të borxhit të dy vjetëve të fundit gjithsesi ky raport është 1,38, pra qëndron ndjeshëm më lart sesa raporti i qeverisjes së mëparshme.

Nga ana tjetër, dëgjoj shpesh të thuhet që ju jeni “qeveria e borxhit, e marrjes së borxhit”. Unë dua t’ju bëj me dije se huaja e re e brendshme dhe jashtme për periudhën 2008-2013 ka qenë 292,7 miliardë lekë, ndërkohë që për periudhën 2014-2019, pra nëse krahasojmë periudha 5-vjeçare, ka qenë 250,1 miliardë lekë.

Pra, të gjitha ato që u përmendën nga deputetë nuk qëndrojnë, pasi në themel të kësaj qeverisjeje në parim është ulja e stokut të borxhit dhe konsolidimi fiskal.

Për sa i përket raporteve dhe pyetjeve për infrastrukturën, do t’ia kaloj fjalën zëvendësministrit të infrastrukturës,

Ilir Bejtja – Përshëndetje kryetar!

Të nderuar deputetë,

Pyetja ishte a gjeneron fonde institucioni? Në fakt, ndihma e kësaj mbështetjeje buxhetore për sektorin e energjisë është detyrimi i plotësimit të mbylljes së reformës në sektorin energjetik, që të bëjë të mundur mbështetjen buxhetore. Pra, nuk i merr institucioni këto para, janë mbështetje për buxhetin dhe ne jemi *condition precedent*, pra kusht, parakusht që duhet të plotësohet, në mënyrë që të ne të marrim këtë mbështetje buxhetore.

Orikumi është linja e fundit që ne kemi bërë, Fier –Orikum 20 kilovolt. Ka qenë 6 kilovolt. Kjo linjë ka mbaruar në vitin 2019 dhe patjetër që cilësia e furnizimit në Orikum dhe në të gjithë zonën e plazhit është rritur me herë jo me përqindje. Pra, dikur ka qenë në 6 kilovolt, në një zhvillim shumë më të reduktuar në vitin 2019 ka qenë shumë më e zhvilluar nga

pikëpamja infrastrukture. Ne jemi të lumtur sepse edhe e paguajnë energjinë të gjithë banorët, pra nuk kemi probleme me pagesën energjisë në atë zonë dhe investimi është i kryer, pra nga 6 kilovolt, në 20 kilovolt. Kjo është ajo që i kërkohet zonës.

Nga ana tjetër, për ta fuqizuar furnizimin me energji elektrike, ka mbaruar po në vitin 2019 linja Sarandë-Vlorë, 110 kilovolt, me dy nënstacione, një në Himarë dhe një në dalje të Sarandës, të cilat kanë bërë të mundur jo vetëm që të kemi 20 kilovolt, por që thyerja të jetë 110, 20, 04, më përpara ka qenë 35, 6, 04, pra një cilësi shumë herë më e rritur. Kjo ishte për pjesën e energjisë.

Për reformën, dua të them se reforma është hapi i fundit i mbyllje së reformës në sektorin e energjisë. Ne kemi marrë, më së fundi, edhe notën pozitive nga Komitetit i Energjisë. Komunikimi i tyre është publik para datës 30 nëntor, është ende në faqen e Komitetit të Energjisë, Shqipëria është vendi i parë në Ballkanin Perëndimor që kompletton reformën e paketës së tretë të energjisë në energji eklektike, duke përfunduar edhe në ndarjen e operatorit të shpërndarjes nga furnizuesi. Pra, ky ka qenë hapi i fundit për t'u bërë në këtë sektor.

Eduard Shalsi – Zoti Agalliu.

Arbër Agalliu – Atëherë, po e nis me zonzjën ministre të Financave. Ne kemi pasur kurajën këtu në komision në këto muaj, për të dhënë të drejtë aty ku kemi menduar, por nga ana juaj nuk mbaj mend veçse fjalinë që asgjë që themi ne deputetët e opozitës nuk është e vërtetë. Unë besoj se kolegët e mi, përfshirë edhe veten time, nuk kemi thënë të pavërteta gjithë këtë periudhë, kështu që të jesh e bindur se në atë çfarë themi ka të vërteta.

Ndërkohë, për pjesën e borxhit unë kam të dhënat zyrtare. Ju mund të bëni krahasime me vitin 2013, mund bëni krahasime edhe me vitet 1991, 1992, por mendoj se nuk duhet të bëni krahasime me një dekadë më parë, ju duhet ta bëni krahasimin me çfarë keni mundësi, potencial për të zhvilluar dhe meqë zoti zëvendësministër përmendi raportet, sot *International Transparency* e ka nxjerrë Shqipërinë për faqe të zezë në raport me korrupsionin, meqë përmende raportet. Nëse do edhe në sektorin e energjisë, ke plot, ku ka vend abuzimi dhe korrupsioni, sikurse është OSHEE-ja që u kthye, por është temë tjetër kjo, në një çerdhe punësimesh fiktive gjatë periudhës së zgjedhjeve.

E nderuar zonja Ministre, patjetër që mund ta krahasosh ekonominë sot me atë të vitit 2013, edhe më përpara, është në të drejtën tuaj, por nuk e shikoj profesional këtë krahasim. Do të duhet ta krahasoni me mundësitë që ka ky vend sot.

Ndërkohë, i nderuar Zëvendësministër, të ftoj publikisht me median të shkojmë sot në Orikum dhe, nëse nuk ikin dritat, energjia elektrike më pak se 15-20 herë në ditë, unë po vë një

bast publik. Aty ka mungesë të theksuar investimi. Në lera mund ta keni bërë, mund ta keni bërë edhe në realitet, që nuk më rezulton, por fakti është ky, që aty ka mungesë të energjisë elektrike qoftë nga një erë modeste, qoftë nga situata, të cilat nuk jam ekspert dhe nuk di t'i shpjegoj. Ministria juaj ma ka konfirmuar: "Po, është e vërtetë, sepse kemi ankesë edhe nga kompanitë që po punojnë në atë zonë". Unë po të përcjell një shqetësim, meqenëse doli situata.

Në këtë kontekst, në çdo gjë që themi, do të ishte mirë të shikonit elemente që mund t'i merrni, të reflektoni dhe t'i ndryshoni, sepse, nëse pozicionohemi në llogore, që çdo gjë që bëni ju janë gabim dhe çdo gjë që themi ne nuk janë të vërteta, kot sa mblidhemi dhe kot sa diskutojmë.

Eduard Shalsi – Isha në dileme, e ngrite ti dorën përpara apo zoti Leskaj. Kam përshtypjen se zoti Leskaj.

Zoti Xhafaj, më pas zoti Leskaj dhe zonja Denaj.

Etjen Xhafaj – Faleminderit!

Faleminderit, zonja Ministre dhe zoti Zëvendësministër i Energjisë, për prezantimin!

Unë doja të bëjë një ndërhyrje vetëm për këtë debat që po bëjmë me kolegët këtu. Në nivel parimor për çdo ekonomist dhe makroekonomist ky është një debat i duhur, një debat i borxhit.

Nga ana tjetër, besoj po aq fort që, duke pasur kryesisht kontekstin ndërkombëtar qoftë të kohës që po kalon Shqipëria, qoftë të asaj që po kalojnë të gjitha vendet e tjera, pavarësisht tentativave për të menaxhuar borxhin publik, mesatarja e BE-së sot është mbi 100%, aty ka dhe vende që e kanë nën 20% borxhin publik, mesatarja e 26 vendeve në epokën e përballimit të pandemisë. Sidomos edhe me efektet e tërmeteve të 21 shtatorit dhe 26 nëntorit të vitit 2019, besoj se deri diku është legjitimuar kjo gjë, duke pasur parasysh edhe një faktor shtesë, për të cilin kemi debatuar edhe në sallën e parlamentit për sa i përket krizës së energjisë elektrike, një krizë që, pavarësisht se çfarë u përjetua në atë moment, po përjetohet në mënyrë shumë negative nga shumica e fqinjëve tanë, qoftë Greqia, që është një vend i BE-së, qoftë Kosova, që është vendi më afër, të cilin kemi pasur dhe mundësi ta ndihmojmë në këtë kohë.

Do të doja ta theksoja edhe një herë që ky debat në parim është një debat që vlen, por vlen të kujtohet se ajo, që është përqindja e shërbimit të borxhit publik gjatë 8 vjetëve të fundit, ka qenë gjithmonë në ulje, edhe sot tani në një periudhë krizë për të gjitha vendet, sepse kjo është krizë globale e pandemisë COVID-19, Shqipëria është ende duke marrë hua me ritme dhe interesa nën atë që është interesi i shërbimit të borxhit. Besoj se kjo vlen edhe një herë për të theksuar se kjo nuk është një masë emergjente apo tërësia e këtyre masave nuk janë emergjencë,

por në kuadër të shërbimit sa më të mirë që i bëhet borxhit publik dhe, sigurisht, në kuadër të mbështetjes së rimëkëmbjes ekonomike të Shqipërisë.

Eduard Shalsi – Zoti Leskaj.

Bujar Leskaj – Ne po flasim për një hua tjetër 50 milionë euro që merr qeveria përmes OSHEE-së dhe, pa diskutim, siç thotë populli “gjuha shkon ku dhemb dhëmbi. Ne do të flasim për borxhin publik, s’ka rëndësi që është ministrja e Financave dhe zëvendësministri i Energjetikës, për të cilët kam respekt.

Dua të ngre shqetësimin tim, sinqerisht, jua them që po ngre shqetësimin tim qytetar: sa më shpejt që ju të gjithë të largoheni nga filozofia e borxhit si maxhorancë qeveria, në radhë të parë, ministrja e Financave, Kryeministri, ministrat e tjerë, ju, të nderuar deputetë, pavarësisht elokuencës, maskimit të frazeologjisë apo shembujve që mund të jepni me BE-në, aq më mirë është për Shqipërinë. Në programin tuaj të qeverisë të vitit 2021-2025, që ju paraqitet në Kuvend në shtator të vitit 2021, e nderuar zonja Ministre, zotoheni si qeveri se do ta ulni borxhin publik në fund të mandatit, në fund të vitit 2025 dhe do ta çoni në 60% të PBB-së. Ne sot jemi në fundin e vitit të parë tuaj, mandat që teorikisht është 4 vjet, pavarësisht praktikisht se çfarë uron populli për ju, por unë nuk e kuptoj, nuk e di se si mund të ma shpjegoni ju, kur sot e keni borxhin 80%, thoni zyrtarisht të PBB-së; ju keni borxhe të fshehura 16,5% detyrime, kontingjente të koncesioneve PPP-ve e të tjera. Ju keni fatura të fshehura që do të vijnë si detyrim i vendimeve të gjykatave ndërkombëtare dhe jeni të detyruar t’i zbatoni, pavarësisht nga akrobacitë që bëni në fjali, të cilat e çojnë borxhin në 100% të PBB-së. Në vitin 2022, në rast se ky borxh në fund të vitit do të jetë i deklaruar zyrtarisht 100%, 90% dhe 80%, a e shpjegoni dot ju, e nderuar zonja Ministre, se si do ta çoni në fund të vitit 2025 borxhin në 60% të PBB-së, pavarësisht shifrave që ju deklamoni këtu? Ajo është përgatitja juaj, në një farë kuptimi ju nuk jeni në provim të Komisioni i Ekonomisë ose te ne si opozitë, por jeni në provimin e madh të ndërgjegjes suaj profesionale, politike dhe morale në raport me qytetarët shqiptarë. Në shtator të vitit 2021 ju deklaroni se në vitin 2025 do ta kaloni borxhin në 60% të PBB-së. Unë jam i bindur që ju nuk do ta mbani këtë premtim. Ky është një falsifikim, është një mashtrim i madh që bën qeveria juaj, jo ju personalisht, por e theksoj mua më vjen keq, se kjo është filozofia shqiptare që kemi ne. Nuk pres që deputetët e maxhorancës të rrezikojnë karrierat e tyre, të dalin këtu të bëjnë trimin. Nuk ka ndodhur kjo në Shqipëri në 30 vjet; ka ndodhur shumë rrallë dhe nuk kam pse ta pretendoj te ju këtë. Por ne nuk duhet ta inkurajojmë, duhet gjithmonë t’i tërheqim vërejtje, duhet gjithmonë t’i kufizojmë këto hua, të cilat vijnë në forma të ndryshme, një herë vijnë si eurobond. Po t’i shikosh me terma të butë, nuk është me terma të butë, po ta

studiosh thellë të gjithë kontratën e huamarrjes. Të nderuar kolegë, ne kemi nevojë të gjithë që t'i flasim më shumë vetes sonë në aspektin e përgjegjshmërisë dhe të tentojmë forcimin e llogaridhënies ndaj qeverisë në pozicione të ndryshme, ju në atë pozicion që jeni edhe ta mbështesni këtë maxhorancë, por edhe ta kritikoni, edhe ne si opozitë, pavarësisht problemeve tona të brendshme, të mos harrojmë detyrimin që kemi për të demaskuar mashtrimet e kësaj qeverie, politikave të kësaj qeverie, mbi të gjitha, do të thosha se ju duhet të kuptoni se është gabim filozofia që keni: borxh dhe vetëm borxh.

Nuk ka fare konotacion politik kjo që shpreha këtu, sepse u përpoqa t'flisja thjesht qartë edhe si koleg me ju. Nuk e di, por do të më duhet ta rilexoj edhe një herë një vepër të fundit për Titon. Druaj, kam frikë se ofendoj Titon dhe Eduard Kardelin, po ta krahasoj liderin tuaj global me ata për sa u përket politikave të borxhit. Eduard Kardeli ka qenë shumë politikan demokrat, liberal, ekonomist i shquar në teorinë e tij të vetadministrimit. Për Titon kam rezervat dhe urrejtjen time për sa i përket përkrahjes që nuk i ka dhënë popullit të Kosovës, por do ta shikoj me vëmendje atë libër dhe do të përpiqem të gjej ato gjërat e përbashkëta që keni ju. Kam frikë se do ta lini edhe ju, siç la Titoja Jugosllavinë.

Eduard Shalsi – Një gjë është e sigurt që, nëse do të vijë një ditë që nuk do të jemi në pushtet, dhe do të vijë një ditë, sigurisht që do të duhet të prisni shumë gjatë, nuk do ta dorëzojmë as si në vitin 1997 dhe as si në vitin 2013; kjo është e sigurt, pasi dimë fare mirë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E morëm në buzë të humnerës. Meqenëse po flet për sistemin energjetik, e kemi marrë në buzë të greminës, por ky është një debat tjetër.

Po, zonja Denaj.

Anila Denaj – Ky është debati, dhe unë këtë desha të këmbëngulja pak, për t'iu rikthyer çështjes pse jemi mbledhur sot. Ne nuk jemi mbledhur për borxhin. Edhe pse borxhi është pjesë e diskutimit, nuk mund të kthehet borxhi gjithmonë në diskutim politik, por sot jemi mbledhur për një marrëveshje, e cila është pjesë, siç u tha edhe pak më parë, e një memorandumit prej vitit 2018 me disa donatorë. Nuk është vetëm një donator, nuk është bërë pak në këta vjet, sepse kemi arritur deri tek organizimi jo vetëm i operatorit, por dhe *Alpex-it*, bursës së energjisë, për të plotësuar ato kushte që tha zëvendësministri. Kur e morëm, e morëm jo vetëm me humbje, ne e dimë shumë mirë, por me tragjedi kombëtare, ashtu siç e la Partia Demokratike.

Po, zoti Agalliu, është e rëndësishme të kthehemi në vitin 2013, jo vetëm për menaxhimin e borxhit dhe shifrat që tha ministrja, që nuk dua t'i përsëris, sepse është gati më shumë se sa përgjysmuar kostoja e borxhit. Ju jeni bankier, e dini shumë mirë që afatet e

zgjeruara vijnë në avantazh të menaxhimit të kostos së borxhit. Të kthehemi në vitin 2013 qoftë për pjesën e reformës së energjisë, sepse akoma nuk ka mbaruar, ashtu dhe për kostot e borxhit, besoj se është legjitime. Megjithatë, unë do t'i kërkoja zëvendësministrit që pjesën e reformës ta shikojnë në të gjithë Shqipërinë. Mund të ketë shumë zona në Shqipëri që akoma kanë nevojë për 20 kilovoltshin, vij si përfaqësues e zonës së Jugut të Shqipërisë, ku zona shumë punëtore në pjesën më jugore janë në pritje, si zona e Finiqit, e Konispolit për 20 kilovoltshin. Shpresoj që kjo reformë, e cila ka nevojë për këto investime, të përmirësojë edhe jetën ekonomike dhe të kthejë pastaj në rentabilitet edhe borxhin, jo ndoshta këtë vit, por në 5-vjeçarin e ardhshëm në mënyrë sistematike.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Denaj!

Zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Faleminderit!

Edhe unë kërkoja të reagoj, sepse dëgjova nga kolegët e opozitës pjesën: “Nuk duam të bëjmë politikë, qëndrimi ynë nuk është qëndrim politik, duam të kemi bashkëpunim, duam të na jepni të drejtë, kur ne ngremë apo adresojmë shqetësime të caktuara dhe nuk duam të jemi zi në një krah dhe bardh në krahun tjetër”, por, nga ana tjetër, besoj që në çdo pjesë të qëndrimit që mbajtët kishte politikë. Debati për borxhin publik është një debat që e kemi pasur çdo herë që kemi përfaqësues të Ministrisë së Financave këtu, po ashtu edhe të ministrive të tjera, por sot, përtej atij debati mbi borxhin publik, ne duhet të shikojmë sesa është rentabiliteti i sektorit energjetik, si është sektori energjetik dhe pse duhet të krahasohet me si ishte dhe si është. Duam apo nuk duam, ne jemi një qeveri, një forcë apo maxhorancë, e cila ka një qasje komplet ndryshe nga ajo që ka pasur maxhoranca e mëparshme. E përmendi pak më parë kryetari i komisionit, zoti Shalsi, por unë mund ta them edhe pak më shumë që ne e kemi gjetur në vitin 2013 sektorin energjetik në kolaps total. Po ashtu, një nga kontribuuesit më të mëdhenj të borxhit publik, mund të vazhdoj më tutje, ishte sektori që normalisht duhet të jetë sektori parakusht për zhvillimin ekonomik të vendit, një sektor, i cili pengonte zhvillimin ekonomik të vendit. Në këtë komision kemi qenë me përfaqësues të bizneseve të caktuara, ku shqetësim kryesor asokohe nuk kishin sesa në partneritet ishin me qeverinë dhe sesa iniciativat apo lehtësirat fiskale mund të ndikonin pozitivisht për zhvillimin e biznesit të tyre, por problemi kryesor ishte: nuk kishin energji elektrike të vazhdueshme për të vijuar me proceset prodhuese të tyre. Prandaj është qasje komplet tjetër, do të duhet të krahasojmë veten, madje jo vetëm me vitin 2013, por patjetër që do të kthehemi edhe në vitin 2005, sepse vitet 2013-2021 për nga totali i investimeve në sektorin energjetik barazohet me 50 vjet më parë, jo më me 8 vjet që keni qenë në qeverisje, as me 30 vjet

demokraci. Ka zona të tëra të Shqipërisë që në këta 8-9 vjet tashmë kanë pasur investime, të cilat nuk i kanë parë në 50 vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Je i qarkut të Vlorës.

Unaza energjetike, që është investuar në atë qark, ka qenë kushti kryesor i zhvillimit të sektorit të turizmit që kontribuon në ekonomi. Ne jemi Komisioni i Ekonomisë dhe duhet ta themi me gojën plot. Ka shumë zona, ku duhet të investohet, patjetër duhet të vijohet të investohet, por nuk mund t'i mohojmë ato që janë bërë.

Në aspektin tjetër këtu diskutojmë për një marrëveshje huaje, e cila është në kuadër të strategjisë për vijimin e reformës në sektorin energjetik. Besoj që vërtet do të duhet të diskutojmë, të debatojmë për borxhin publik, për sektorët e ndryshëm të ekonomisë, por në mënyrë të veçantë do të duhet që për sektorin energjetik t'i themi të gjitha ashtu siç janë. Të diskutojmë se çfarë kontributi ka ky sektor në të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të shtetit. Ndërkohë, do të duhet të shikojmë, sepse investimi në këtë sektor ka bërë të mundur jo vetëm ulje të humbjeve në rrjet, që kanë qenë katastrofë më parë, jo vetëm vjedhjet në rrjet që kanë qenë po ashtu, por duhet të diskutojmë atë çfarë është për të gjithë ekonominë shqiptare parakushti, që është energjia dhe jo vetëm, por edhe pjesa infrastrukturore se mund të vijojmë me të tjera.

Në këtë aspekt, jo vetëm duhet të vijojmë sot që ta miratojmë këtë marrëveshje, por besoj që do të duhet ta nxisim pak më tepër Ministrinë e Infrastrukturës, në kuadër të asaj që është edhe Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik të qëndrueshëm, pikërisht që të investojnë në ato zona, që janë prioritare në mënyrë të posaçme për sektorin e turizmit, si një nga sektorët prioritarë dhe kyç të ekonomisë shqiptare. Në këtë aspekt, çdo herë që kemi një mbledhje komisioni dhe në rendin e ditës kemi një marrëveshje apo një çështje të mos kalojmë në çështje të tjera. E diskutuam edhe paradite, vijojmë ta diskutojmë pasdite, do të vijojmë ta diskutojmë në çdo mbledhje, ja ku jemi, biem dakord, të thërrasim ministren përkatëse në dëgjesë për borxhin publik; e kemi thënë, për PPP-të do të diskutojmë, do të diskutojmë për procesin e fiskalizimit, që e kërkuam, dhe sot paradite për të pasur të dhëna të tjera, sepse informaliteti në të gjithë ekonominë shqiptare do të duhet të ulet dhe, nëpërmjet këtij procesi, do ta ndihmojë edhe uljen e informalitetit, po ashtu, edhe në pjesën e politikave fiskale që janë ndërmarrë në nxitje e me radhë, por nuk duhet të harrojmë diçka: jemi mandatuar nga qytetarët shqiptarë për të vijuar me atë që është programi ynë qeverisës dhe qasja jonë për të pasur një ekonomi apo zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Në këtë aspekt, jeni në opozitë, jemi në

maxhorancë, jemi votuar për të qenë në maxhorancë dhe do të duhet të jeni alternativë, nuk do të duhet të jeni gjatë gjithë kohës duke diskutuar: përse? Jo! Ngrini shqetësime, të bëjmë adresimin e shqetësimeve, jo gjatë gjithë kohës politikë, duke thënë: “Ne nuk bëjmë politikë.”.

Arbi Agalliu – Unë nuk arrij të kuptoj pse i keqperceptoni ato që thashë. Unë bëra dy pyetje. A ka ndonjë studim në raport me këtë borxh? Si do të ndikojë në ekonomi? Nuk thashë asgjë përtej kësaj. Për të thënë ka plot dhe boll, sa të doni. Por ishte zonja ministre që për çdo gjë që thamë, tha se ne ishin të pavërteta. Është në të drejtën time të them se ne kemi pasur kurajën disa herë, jo një herë, kur ka qenë në optikën tonë diçka apo një projektligj, një diskutim, kemi rënë dakord, kemi thënë: po, por nuk kam dëgjuar. Edhe kur ne kemi thënë po, përsëri është thënë: “Nuk e keni mirë, është gabim.”.

Unë kërkova të dija, a ka ndonjë studim në raport me këtë borxh? Si i kthehet ekonomisë? Meqë u përmenda nga zonja Denaj si bankier, unë nuk di të shkojë dikush në bankë, të kërkojë kredi, pa një plan biznesi se si kthehet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për afatin, afati 12 vjet. Unë thashë që është përgjegjësi e qeverisë, nëse merr borxh përtej afatit të mandatit të saj, ka dy herë më shumë përgjegjësi se sa kur e merr brenda afatit, sepse impakton edhe çfarë vjen më pas. Në këtë kontekst, unë doja të dija, a ka apo jo? Ky ishte diskutimi, pastaj sa probleme ka, sa hajdutë me çizme ka në administratë e kudo, flasim sa të doni, nuk është problem. Se ju mandatuan apo se u vodhën apo se fituat apo se humbëm, flasim edhe për këto sa të doni, por unë vetëm dy pyetje bëra. Shumë e thjeshtë.

Eduard Shalsi – Patjetër me citimin e Eduard Kardelit sot na çakordove fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bujar Leskaj – Është gjyshi i një mikut tim, Kardeli; e vërtetë.

Eduard Shalsi – Slloven?

Bujar Leskaj – Po, ish-presidenti i gjykatës sllovene të auditimit. Përpos të tjerave, është figurë e lartë politike dhe e ekonomisë.

Eduard Shalsi – Komuniste.

Bujar Leskaj – Nuk ka lidhje... Diskutojmë një herë tjetër.

Eduard Shalsi – Na çakorduat tani me... Dishepull i titoizmit është, komunist dhe...

Bujar Leskaj – Ju e keni lidhjen organike. Unë prandaj zgjodha dhe thashë që do të mendohem. Do ta rilexoj Josip Broz Titon dhe do të bëj krahasime ndërmjet Titos dhe liderit tuaj global. Kaq. Për Edvard Kardelin kam shumë respekt. Unë isha shumë i qartë dhe do të kem rast herë tjetër t’jua them, pasi të bëj disa saktësime. Mund të bëj dhe një shkrim...

Eduard Shalsi – E di kush është? Është arkitekti i...

Bujar Leskaj – I vetadministrimit jugosllav.

Eduard Shalsi – Jo i vetadministrimit, ajo quhet *worker self-management*, pra i vetadministrimit punëtor. Megjithatë, dakord.

Vazhdojmë.

Bujar Leskaj - Natyrisht, ai është krijuesi dhe ideuesi i vetadministrimit punëtor, ndërsa Enver Hoxha, pararendësi juaj, e quajti vetadministrimi jugosllav dhe shkroi veprën, që ia shkruan të tjerët, “Vetadministrimi jugosllav, teori dhe praktikë kapitaliste”. Të rinjtë apo intelektualët, kur lexonin këtë vepër, krijonin respekt për Edvard Kardelin. Kaq. Bëhet fjalë për vitet '80-'90.

Megjithatë, të kthehem te kjo. Të paktën unë, në atë diskutim të shkurtër, kur përdora shprehjen që nuk flas në kuptimin politik, nuk e kisha për t'u justifikuar te ju, se ne, natyrisht, jemi deputetë të forcave të caktuara politike dhe jemi njerëz politikë, kjo nuk diskutohet, në çdo fjalë, në çdo gjuhë, në çdo fjalë, në çdo mendim që artikulojmë këtu, por ju bëra një thirrje qytetare, që të jemi më të përgjegjshëm. Ne, si komision, si deputetë, të ngremë zërin tonë, në kundërshtim me këtë filozofinë e borxhit. Ky është mendimi im personal. Këtu unë gërshetoj dhe mendimin politik, dhe mendimin personal. Në këtë kontekst e kisha, jo se kemi komplekse që flasim apo jo politikisht.

Edhe Arbi ishte shumë i saktë, ishte në të drejtën e tij. Mua nuk më erdhi mirë për bastin që vuri, por kam qejf që zëvendësministri të shkojë një herë në Tragjas, Dukat e Radhimë dhe ta shikojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të shkosh dhe të qëndrosh, siç tha ai. Të qëndrosh 24 orë dhe të shikosh pastaj se si do të dalësh nga ata fshatarët, se ata janë fshatarë me çika, edhe të mençur, edhe trima, edhe politikanë.

(Zoti Eduard Shalsi flet pa mikrofon)

Delina Ibrahimaj – Dhe zëvendësministrin.

(Zoti Eduard Shalsi flet pa mikrofon)

Shumë shkurt, edhe unë, me shumë respekt, i kam dëgjuar si deputetët e pozitës, ashtu dhe të opozitës, me të gjitha komentet që kanë bërë gjatë gjithë periudhës kur kam qenë ministre. Përgjigjen e pyetjes së zotit Agalliu e dhashë që në fillim, duke iu referuar raportit të rritjes ekonomike ndaj rritjes së stokut të borxhit.

Kam një listë të gjatë me raporte, ku gjatë gjithë kësaj qeverisjeje, sigurisht, ato janë shumë më të mira se raportet e qeverisjes së mëparshme, ku mund t'i referohemi raportit të investimeve ndaj huamarrjes, sepse, nëse duam të bëjmë një analizë se ku shkon ky borxh dhe çfarë efekti ka në ekonomi, janë pikërisht këta treguesit që duhet të shohim dhe të analizojmë, nëse janë në rritje apo jo. Në fakt, kanë qenë në rritje jo vetëm për periudhën deri në vitin 2019, kur edhe stoku i borxhit ka qenë në rënie ndaj GDP-së, por dhe gjatë këtyre dy viteve të fundit, pra në krahasim me 2013-n. Kështu që, sigurisht që i marrim parasysh, sigurisht që jemi të vetëdijshëm që niveli i borxhit është shumë i lartë në këtë moment dhe për këtë arsye, në buxhetin që ka kaluar në këtë komision, kemi parashikuar që borxhi do të vijë në reduktim dhe në ulje, një premtim i cili është mbajtur nga qeveria që në vitin 2013 e deri në vitin 2019, para periudhës së krizave. Ne do t'i qëndrojmë këtij premtimi dhe do t'i qëndrojmë reduktimit të borxhit dhe konsolidimit fiskal.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Po, zoti Bejtja.

Ilir Bejtja – Shkurtimisht, unë nuk dua të them që nuk ka ndërprerje dritash. Krahasimi ishte me çfarë ka qenë. Ju thatë që nuk janë bërë investime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Kemi edhe ne Dukat në Elbasan.

Bujar Leskaj – Nga Dukati i madh, nga Dukati ynë?

Ilir Bejtja – Jemi veç, por aty-aty jemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I kam.

Ideja është që ne kemi rritur investimet atje. Siç ju thashë, të dyja linjat, dhe unaza e bregdetit, 110-ta, dhe 20-ta, janë përfunduar, tani është duke u bërë *upgrade*-imi në 04, pra jo në tela ajrorë, siç kanë qenë dikur dhe siç mund të ketë ende në vazhdim, se është duke u punuar, por në ABC, në mënyrë që të mos ketë ndërhyrje, por, gjithashtu, dhe humbja (të më falni, se nuk është për sfide) për shkak të rezistencës omike të jetë shumë e ulët, se ABC-ja është e izoluar, pra nuk humb fare nga mjedisi. Brenda këtij viti mbaron si investim, pavarësisht situatës shumë të vështirë që kemi pasur për shkak të kostove të rritura të energjisë, dhe në sezonin e ri të plazhit fillohet me rrjetin e ri, pra për të gjithë zonën e bregdetit të Jugut, përfshirë dhe Vlorën. Mbi Vlorën këto kanë qenë bërë më përpara, pra kap Fierin, Elbasanin, Tiranën. Janë linja të mbyllura dhe janë të gjitha 400/110/20. Nuk e kemi mbyllur në shumë vende këtë histori. Është

rreth 970 milionë dollarë nevoja totale për *upgrade*-imin e të gjithë rrjetit në të njëjtin standard: 110/20/04.

Ka plot zona, siç thatë ju, ku është ndërhyrë para 36 ose 40 ditëve. Me një ndërhyrje që kemi bërë para rreth 5-6 vjetësh në nënstacionin e ri, që u bë në zonën e Kuçovës, kemi hequr transformatorin e prodhuar më 1935-n në Itali, i cili ishte në punë. Pra, kemi raste të tilla plot. Kemi defekte dhe aty ku kemi ndërhyrë, sepse ndoshta është bërë ndërhyrje e pjesshme për të rregulluar një segment. Megjithatë, defekti nuk vjen vetëm nga një ndërhyrje e vetme, por duhet kapur e gjithë linja, i gjithë Fideri, duhet ndryshuar sistemi, duhet hequr fare tensioni i lartë 35 kilovolt, që nuk ka pse të ekzistojë në kohët e sotme. Humbjet janë shumë të larta dhe çdo gjë është ajrore, punohet me kavo çeliku dhe jo bakri e të tjera me radhë.

A kemi mundësi t'i bëjmë? Vazhdojmë t'i bëjmë.

Për këtë do t'ju jap dy elemente, të cilat lidhen me gjendjen e borxhit. Nuk po marr krahasime me 2013-n, por me 2016-2017-n, kur vendosëm t'i bëjmë më të vështira për t'u arritur targetet në sistemin elektroenergjetik, pasi u arritën shumë lehtë ato që ishin të bazuara në planin e rimëkëmbjes, ku kemi ndryshuar dhe pasqyrën e humbjeve e të gjitha me radhë. Borxhi në KESH ka qenë 74 miliardë lekë, 12 herë Epidan, sot është 1,5 herë Epidan, pra borxhi që ka marrë KESH-i për vete. Po kështu, OSHEE-ja është në 2,8 herë Epidan. Kur e kemi filluar këtë punë ka qenë me 78 miliardë lekë EKT negative, kur asetet ishin të vlerësuara rreth 26 miliardë lekë. Pra, i gjithë borxhi, që kishte "ngrënë" kapitalin e vet, ishte mbi 100 miliardë lekë dhe faturat e papaguara kanë qenë 1 miliard e 160 milionë dollarë, ato që ishin të maturuara mbi një vit, pra jo 180 ditë të maturuara, të provigjionuara. Provigjionimi ka qenë mbi 32%.

Për sa i përket pyetjes së parë që bëtë ju: "A ka fonde vetë institucioni?", rritja ka qenë e vazhdueshme. 2021-shin e mbyllëm me 72 miliardë lekë të ardhura. Pra, çdo vit ka pasur rritje, edhe arkëtimet janë rritur, janë mbi 87,3, që është pjesa e parashikuar në tarifë e arkëtimeve. Sot ne themi që jemi mbi 93% të faturës korente dhe humbjet nuk i kemi 53%, sa i kemi pasur në dhjetor të 2013-s, por 20%.

Ka akoma vend për përmirësime? Sa të duash! Ne duhet të shkojmë në humbjen 3,7%, që do të thotë në sistemin 110/20/04. Kjo është mënyra e vetme që mund ta arrijmë.

Kemi dhe raste abuzimesh, të cilat nuk janë për faj të qytetarëve, por, në radhë të parë, janë për faj të punonjësve tanë, që e lejojnë këtë dhe shpeshherë janë në bashkëpunim dhe ne vazhdojmë t'i dënojmë. Po ju jap një mesatare: mbi 700 veta në vit pushohen me motivacion në OSHEE Group, të cilët janë të gjithë shqiptarë. Ndoshta të punojmë me sistemet e edukimit dhe të shpërndarjes së kulturës së integritetit ndër njerëz. Si shkohet? Kjo është e gjitha shqiptare. Ka

përmirësim dhe ju nuk doni që ne ta themi këtë. Ka, sepse më parë pushoheshin nga puna dhe çoheshin për ndjekje penale. Vetëm në vitin 2015 2104 persona, punonjës të OSHEE-së, kanë shkuar për ndjekje penale. Pra, është një betejë e vazhdueshme për përmirësimin e menaxhimit, rritjen e investimeve, uljen e humbjeve, përmirësimin teknologjik dhe patjetër, të jemi të ndihmuar nga të gjithë.

Këto kishim merak, por do ta vizitojmë vendin dhe nëse do të ketë probleme, do të bëjmë çmos t'i riparojmë.

Eduard Shalsi – Atehere kalojmë në vitimin e marrveshjes.

Kush është dakord për ta miratuar në parim?

Pro? Kundër?

Jeni Kundër?! (Referuar Bujar Leskaj)

Apstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Apstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Apstenim?

Miratohet.

Në tërësi.

Pro? Kundër? Apstenim?

Miratohet

Shumë faleminderit

Sekretare e komisionit
Enxhemvera Zake

Përgjegjësjë e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar Administrativ
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.01.2022, ora 15:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

2. Projektligji “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Blerina Gjylameti, Shpresa Marnoj, Enslemvera Zake, Arbi Agalliu, Dashamir Shehi, Emilja Koliqi, Edmond Spaho, Benet Beci, Anila Denaj, Bujar Leskaj, Ilir Topi

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Alfred Rushaj, Agron Shehaj, Erion Braçe, Vullnet Sinaj, Sorina Koti, Antoneta Dhima, Pranvera Resulaj, Alban Xhelili,

Të ftuar:

Adea Pirdeni - Zëvendësministre e Drejtësisë.

Besmir Beja - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Nikolla Lera - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale.

Zarina Taja - Drejtor i Drejtorisë së Harmonizimit Fiskal.

Ilda Koja - Drejtor i Drejtorisë Ligjore dhe Teknike.

Saimir Mucmataj - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator.

Idlir Gjata - Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Vasilika Vjero - Zëvendësministër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Zarina Taja - Drejtor i Drejtorisë së Harmonizimit Fiskal.

Nikolla Lera- Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale.

Idlir Gjata - Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Eduard Shalsi – Pa humbur kohë, do t’ua jap fjalën përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë për të bërë një paraqitje sa më koncize.

Më pas do të marrë fjalën relatorja dhe do të vazhdojmë me pyetjet dhe përgjigjet.

Fjala për ju

Adea Pirdeni – Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Sot kemi shqyrtimin e projektligjit “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”. Ky projektligj ka qëllim të krijojë një kornizë të plotë ligjore për formalizimin e profesionit të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme dhe veçanërisht të forcojë mekanizmat e kontrollit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Ky projektligj në vetvete përbën një risi, sepse rregullon për herë të parë aspektet kardinale të ushtrimit të këtij profesioni. Kjo nismë ligjore vjen në vazhden e plotësimit të angazhimeve në nivel të lartë politik që ka ndërmarrë Republika e Shqipërisë për të zbatuar rekomandimet e Taksforcës për veprimin financiar FATF dhe *Moneyval*. Raporti MER 2018 e ka cilësuar sektorin e pasurive të paluajtshme si një sektor me risk të lartë të pastrimit të parave dhe, gjithashtu, në raportet e vlerësimit të ICRG-së është ritheksuar në mënyrë të vazhdueshme se do të jetë e nevojshme të hartohet një kuadër ligjor që mundëson parandalimin e depërtimit të elementeve kriminale përgjatë zinxhirit të kryerjes së transaksioneve në pasuritë e paluajtshme, përfshirë edhe rregullimin e rolit të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme.

Pavarësisht faktit se ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme janë tashmë subjekte të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave, lind si domosdoshmëri rregullimi specifik ligjor i këtij profesioni, si një ndër hallkat e rëndësishme në kryerjen e transaksioneve për kalimin e së drejtës së pronësisë, si dhe të drejtave të tjera reale në pasuritë e paluajtshme. Propozimi i këtij projektligji ndërmerret në përputhje të plotë me programin qeveritar 2021-2025

dhe objektivat specifike të këtij programi në drejtim të forcimit të luftës kundër krimit në përgjithësi, luftës kundër krimit të organizuar në veçanti dhe parandalimin e prurjeve financiare të paligjshme në ekonominë e vendit. Ky projektligj normon kushtet dhe kriteret profesionale për subjektet që ofrojnë shërbimin e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme dhe parashikon mekanizmat kontrollues, me qëllim shmangien e abuzimeve dhe evidentimin e rasteve të dyshuara në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Vëmendje e veçantë në këtë projektligj i është dedikuar mbikëqyrjes së veprimtarisë së ndërmjetësve, e cila realizohet nga ministri i Drejtësisë.

Përpos të gjitha aspekteve të evidentuara për sa më sipër, më lejoni të përmend vetëm disa nga risitë e këtij projektligji.

Së pari, ky projektligj parashikon certifikimin si një parakusht të domosdoshëm për ushtrimin e këtij profesioni. Bazuar në këtë projektligj, ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme do të certifikohen nga ministri i Drejtësisë, i cili, përpara certifikimit, do të garantojë një proces verifikimi të plotësimit të kriterëve ligjore, përfshirë edhe parandalimin e infiltrimit të subjekteve kriminale në këtë profesion.

Së dyti, në ligj është përcaktuar detyrimi i kryerjes së programit të trajnimit për këdo që do të certifikohet për ushtrimin e këtij profesioni. Në projektligj parashikohet që ky program trajnimi mund të kryhet nga ASPA, nga institucione akademike të akredituara, ose nga organizata jofitimprurëse që janë të certifikuara për ushtrimin e këtij trajnimi.

Së treti, çfarë është gjithashtu e rëndësishme, ky ligj synon të garantojë edhe një tranzicion të butë nga situata aktuale, ku nuk ka një rregullim ligjor specifik që i drejtohet këtij profesioni në rregullimin që parashikon ky projektligj. Sipas këtij projektligji, të gjithë ndërmjetësit që kanë ushtruar këtë profesion për së paku 12 muaj nga momenti i hyrjes së fuqi të këtij ligji, konsiderohen si *ipso jure* të certifikuar për ushtrimin e këtij profesioni, mjafton që ata të plotësojnë kriteret ligjore. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, këto subjekte paraqesin kërkesë pranë ministrit të Drejtësisë, i cili merr në shqyrtim kërkesën.

Dua të sjell në vëmendje të veçantë të anëtarëve të nderuar të këtij komisioni se ky projektligj është konsultuar me të gjitha grupet e interesit, janë marrë parasysh një pjesë e mirë e modeleve më të mira për rregullimin e këtij profesioni dhe kemi pasur kontakte të vazhdueshme me organizatat e ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme ose me ndërmjetës individual në takime pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Gjithashtu, kemi marrë komente, një pjesë e të cilave janë reflektuar, një pjesë e të cilave mund të jenë refuzuar dhe për secilin *feedback* të marrë iu është dhënë përgjigje të gjithë personave të përfshirë në konsultim.

Më lejoni këtu, të nderuar deputetë, të përmbyll këtë ekspozitë të projektligjit, duke shprehur bindjen dhe besimin e plotë që nëpërmjet këtij projektligji kemi synuar të ngremë një arkitekturë të qëndrueshme për normimin e profesionit të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme dhe, gjithashtu, kemi vendosur baza solide për forcimin e luftës kundër parandalimit të pastrimit të parave.

Natyrisht që mbetemi në dispozicion të anëtarëve të këtij komisioni për çdo pyetje dhe koment që do të çmohet me vlerë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Pirdeni!

Zonja Gjylameti, në cilësinë e relatores.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

E falënderoj zëvendësministren për prezantimin!

Vlen për t'u theksuar se ky komision e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi. Komisioni përgjegjës është Komisioni i Ligjeve, me të cilët kemi dakordësuar të gjitha ndryshimet që donim të bënim dhe ka marrë formë përfundimtare, duke reflektuar në atë që do të kalojë në seancë.

Qëllimi i projektligjit “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme” ka për qëllim rregullimin e ushtrimit të profesionit të ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme, mbrojtjen e interesave të ligjshme të tyre dhe të çdo shtetasi, përmes garantimit të ligjshmërisë gjatë ndërmjetësimin të veprimeve juridike për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme apo të të drejtave reale mbi to.

Objektivi kryesor i projektligjit është përcaktimi i rregullave specifike dhe të unifikuara për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre, përcaktimin e shkeljeve disiplinore dhe të procedurës së masave disiplinore ndaj ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme, përfshirë të drejtën e ankimit, ekzekutimit të vendimit e të tjera.

Projektligji mundëson realizimin e disa objektivave të tjera ambicioze, që në mënyrë të përmbledhur konsistojnë si më poshtë:

Së pari, mundëson hartimin e rregullave për certifikimin, mbrojtjen dhe garantimin e profesionit të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, si një profesion i lirë dhe i rregulluar, që

do të ketë objekt të veprimtarisë së tij kryerjen e veprimeve juridike për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme ose të drejtat reale mbi to.

Së dyti, kontrolli ligjor tashmë do të shtrihet edhe në sektorin e pasurive të paluajtshme mbi veprimet juridike për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme ose të të drejtave reale mbi to në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Kjo do të arrihet përmes vendosjes së detyrimit për raportim për çdo dyshim të lindur lidhur me masat e vigjilencës në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Së treti, certifikimi dhe përfshirja e të gjithë ndërmjetësve të certifikuar në një regjistër unik të ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme, i cili do të administrohet, mirëmbahet dhe përditësohet në vijimësi nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë. Ky regjistër do të japë informacion të plotë, ndër të tjera, edhe për ndërmjetësit, ndaj të cilëve janë marra masa disiplinore apo iu është revokuar certifikata për llojin e shkeljeve disiplinore të kryera prej tyre dhe masat disiplinore respektive me të cilat janë penalizuar, afatin e vlefshmërisë së masës, e të tjera.

Ky projektligj ka disa risi, si mënyra e veçantë në ndikimet sociale, mbështetur në raportin e ndikimit RIA. Projektligji vlerësohet të ketë ndikim social në këto aspekte:

Së pari, në rritjen e standardeve në ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme nga profesionistët e fushës; në rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë për rolin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme dhe ndërmjetësimin e veprimeve juridike për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme apo të të drejtave reale mbi to në përputhje me legjislacionin në fuqi; në përmirësimin e transparencës gjatë transaksioneve me objekt pasuritë e paluajtshme, element ky që vlerësohet se do të rrisë besimin e shoqërisë në rolin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme.

Ky projektligj përbëhet nga 8 krerë dhe 40 nene, të cilat unë nuk jam duke i renditur, pasi, kur të vijojmë me votimin, do t'i diskutojmë të gjitha sugjerimet që janë marrë parasysh në Komisionin e Ligjeve qoftë në pjesën e teknikës legjislative apo edhe ndryshimet që duhen pasur parasysh.

Gjithashtu, vlen të përmendet se konsultimi publik është një nga ligjet që ka qenë nga më seriozët e mbajtur ndonjëherë me tryeza të organizuara nga Ministria e Drejtësisë, por jo vetëm, edhe nga portali i Ministrisë së Drejtësisë për të gjithë ata që kishin sugjerime për ta përmirësuar kuadrin ligjor. Ndërkohë, për sa i përket pjesës së efekteve financiare, ky projektligj mbahet për

kosto financiare në shumën prej 3 milionë 708 mijë, të cilat janë përsëri të përfshira brenda tavaneve buxhetore të miratuara për Ministrinë e Drejtësisë.

Shpenzimet e personelit janë për tre specialistë, që mesatarisht llogariten në shumën 91 mijë lekë në muaj, shpenzimet për shpërblimin e kryetarit dhe të 4 anëtarëve të komisionit disiplinor për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme për jo më shumë se 12 mbledhje në vit, si dhe nja tabelë që shoqëron projektligjin.

Efektet financiare, sikundër e përmenda pak më parë, janë të përfshira në tavanet buxhetore.

Në përfundim, për sa evidentova më sipër, duke vlerësuar se miratimi i këtij projektligji do të mundësojë rregullimin e ushtrimit të profesionit të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, mbrojtjen e interesave të ligjshme të tyre, si dhe të çdo shtetasi përmes garantimit të ligjshmërisë gjatë ndërmjetësimit të veprimeve juridike për kalimin e pronësisë të sendeve të paluajtshme ose të të drejtave reale mbi to, i rekomandoj komisionit ta miratojmë atë.

Kur të kalojmë në fazën e miratimit nen për nen, do të doja të diskutonim për sugjerimet që ne kemi bërë dhe se si kanë ndryshuar në fazën përfundimtare, të cilat janë marrë parasysh në Komisionin e Ligjeve.

Faleminderit, kryetar!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Atëherë, pyetje nga kolegët?

Në fakt, është një moment shumë interesant, pasi për herë të parë vendosen disa rregulla në këtë sektor dhe shpresojmë me këto norma të kalojë në një hap cilësor edhe ky shërbim.

Po, zoti Leskaj

Bujar Leskaj – Unë, në fakt, kam një falënderim, së pari, për zëvendësministren dhe këshilltaren e ministrit! Te paraqitja e këtij projektligji konstatoj një gjë të veçantë, sektori i kërkimeve, i botimeve dhe biblioteka e parlamentit na kanë përcjellë një material: “Rregullime ligjore për profesionin e agentit të pasurive të paluajtshme në disa vende europiane”. Ky material është përgatitur nga dy zonjusha, Evda Mema dhe Akuila Kola, të cilat, së bashku me drejtoreshën Lidra Bushati, dëshiroj t’i falënderoj! Për ne, si deputetë, në këto raste le të krijohet një traditë e mirë e përcjelljes së materialeve, pse jo edhe nga stafet e ministrive, kabinetet e ministrave, që në fazat përgatitore të ligjit. Vërtet i falënderoj dhe i uroj suksese Sektorit tonë të Botimeve Parlamentare.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Këshilltarja më befasoi pak tani, pasi po më thotë se nuk është në dijeni të këtyre materiale. Nuk je në dijeni?

(Diskutime pa mikrofon.)

Në rregull, ndoshta duhet ta rregullojmë që t'i bëjmë *share* materialit, edhe me ...

(Diskutime pa mikrofon.)

Atëherë, mund të kalojmë direkt në votim? Dakord! A jeni dakord në parim me projektligjin “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Unë do t'i citoj nenet, ndërkohë që zonja Gjylameti do të ndërhyjë aty ku ka ndryshime.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3?

Blerina Gjylameti – Në nenin 3, përpara çdo përkufizimi, sugjerohet vendosja e fjalëve “është”, “janë”, “ka të njëjtin kuptim me”, në varësi të kontekstit të fjalisë.

Në pikën 3 sugjerohet të hiqet togfjalëshi “si toka, burimet dhe rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën”.

Pika 4, për qartësi dhe në vijim të procesit të konsultimit, nismëtarët dhe grupet e interesit sugjerohet të riformulohet me përmbajtjen si vijon: “Person i lidhur është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me ndërmjetësin e pasurive të paluajtshme ose kandidatin për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme, i përbërë nga bashkëshorti, bashkëjetuesi, prindërit, fëmijët dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, si dhe çdo person fizik ose juridik që dihet botërisht se ka ose ka pasur marrëdhënie të ngushta biznesi.”

Pika 6, për saktësim, sugjeroj të riformulohet me përmbajtjen si vijon: “Veprime juridike me pasuritë e paluajtshme është çdo lloj veprimi juridik që ka si objekt kalimin e së drejtës së pronësisë së pasurive të paluajtshme ose të të drejtave reale mbi to, ku përfshihen, por pa u kufizuar, kontratë shitjeje, shkëmbimi, qiraje ose enfiteozë.”

Pra, janë marrë parasysh sugjerimet që kemi bërë nga Komisioni i Ligjeve dhe është riformuluar sikundër unë lexova.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Neni 3 me sugjerimet e bëra. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4?

Blerina Gjylameti – Jemi në rregull!

Eduard Shalsi – Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 20. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 21. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 22?

Blerina Gjylameti – Në nenin 22 të projektligjit sugjerohen këto ndryshime: “Në shkronjën “a” të pikës 1 fjalët “legjislacionin në fuqi” zëvendësohen me fjalët “të këtij ligji. Në pikën 5 fjalët “të pikës 3” për saktësim sugjerohet të zëvendësohen me fjalët “të pikës 2”, pasi duket qartë që është një gabim material”. Pra, është marrë parasysh.

Eduard Shalsi – Kush është dakord me propozimet për nenin 22?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 23. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 24. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 25. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 26. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 27?

Blerina Gjylameti – Në shkronjën “c” në pikën 2 të nenit 27 të projektligjit fjalët “për shkak të kalimit të afateve” sugjerohet të hiqen si të panevojshme dhe është marrë parasysh.

Eduard Shalsi – Dakord me ndryshimet e propozuara në nenin 27?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 28. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 29. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 30. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 31. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 32. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 33?

Blerina Gjylameti – Në nenin 33 të projektligjit hiqet pika 3, e cila spostohet në nenin 32 të projektligjit.

Eduard Shalsi – Dakord me ndryshimet e propozuara në nenin 33?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 34. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 35. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 36. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 37. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 38. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 39. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 40. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Atëherë, faleminderit zonja Pirdeni dhe zonja Xhina!

Faleminderit, kolegë deputetë për debatin!

Shihemi nesër në mbledhjen e orës 10:00.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

**Sekretare e komisionit
Ensemvera Zake**

**Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

**Sekretar Administrativ
Elvi Prifti**